

Njoftim per rihapjen e shkolles.

Te nderuar prinder,

Fillimisht ju urojme nje vit te mbare akademik!

Faleminderit per interesimin dhe pyetjet tuaja ne lidhje me rihapjen e shkolles. Do ju japim informacion me te detajuar kur te marrim njoftim nga Ministria e Arsimit. Megjithate per momentin po ju dergojme udhezimet me poshte. Ju lutem gjeni bashkangjitur nje harte te shkolles, te cilen mund ta perdorni per te kuptuar me mire udhezimet e meposhtme.

Testimi per COVID

Ju falenderojme per pyetjet e shumta qe keni ngritur mbi kete shqetesim, por fatkeqesisht po presim akoma nje urdher ne lidhje me kete ceshtje. Ne momentin e pare qe na komunikohet vendimi do t'ju lajmerojme menjehere.

Orari i shkolles

Cdo person qe futet ne ambientet e shkolles do kaloje nepermjet kontrollit te temperatures. Ne harte do shikoni hyrje te ndryshme. Tabela me poshte tregon grupet e klasave ne menyre qe te dini hyrjen e femijeve tuaj se bashku me orarin. Vini re qe mund te hapim portat me shpejt ne menyre qe t'i japim secilit femije mjaftueshem kohe per mengjesin dhe pergatitjen per mesim. Ndhimesa juaj ne zbatimin e ketyre orareve do na ndihmonte shume.

KLASA	HYRJA& DALJA	NR I NXENESVE	NISJA	MBERITJA
PARASHKOLLOR	1	10	07:15	15:00
I	1	20	07:15	15:00
II A+B	2	16	07:15	15:00
III	5	10	07:15	15:00
IV A+B	5	16	07:15	15:00
V	5	12	07:15	15:00
VI A+B	7	17	07:15	15:00
VII A+B	7	15	07:15	15:00
VIII	9	12	07:15	15:00
IX A+B	8	16	07:15	15:00
X	12	16	07:15	15:00
XI A+B	10	16	07:15	15:00
XII A+B	13	16	07:15	15:00

TE GJITHE NXENESIT NE AUTOBUSE DO HYJNE NGA PORTA 1 DHE DO TE DALIN NGA PORTA 1.

Pjesmarja ne dite te ndryshme

Ne kemi plotesuar te gjitha kushtet dhe jemi ne gjendje te vijojme mesimin ne shkolle 100%.

Rregullimi i klasave

Cdo klase ne shkolle eshte pergatitur sipas kerkesave te ardhura nga Ministria e Shendetesise, duke respektuar rregullat e distancimit social. Javen e ardhme do t'ju dergojme foto edhe video te klasave

ne menyre qe prinderit dhe nxenesit te mund te shikojne paraprakisht rregullimin dhe zbatimin e te gjitha kushteve te sigurise.

Maskat

Maskat jane te detyrueshme per te gjitha klasat. Do t'ju kerkonim te gjithë prinderve qe te siguronin maska per femijet e tyre te pakten dy ne dite ne menyre qe femijet te mund te nderrojne maskat gjate dites. Shkolla do te mbaje maska rezerve ne rast se ndonje maske prishet ose demtohet.

Kontrolli i temperatures

Pavarsisht se ne do te bejme matjen e temperatures cdo dite, prinderit jane te lutur qe cdo mengjes te bejne matjen e temperatures perpara dergimit te femijes ne shkolle. Nese femija ka temperature 37.5 ose me lart femija nuk duhet derguar ne shkolle. Nese gjate kontrollit te temperatures ne shkolle femija rezulton me temperature te larte do te izolohet ne nje nga 2 infermierite, duhet te meren menjehere nga prinderit dhe te dergohen ne shtepi.

Librat

Te gjithë librat do te merren nga nxenesit ne ambientet e shkolles. Persa i perket fletoreve pervec klasave I, II dhe III te gjithë klasat e tjera duhet ti sigurojne fletoret vete.

Autobuset

Per shkak te situates numri i lejuar i nxenesve ne autobuse do te jete i limituar(70% e kapacitetit). Mbulimin e transportit do e kryejme me ane te autobusave tane. Per infomacion me te detajuar do t'ju veme ne dijeni.

Karantina

Per nxenesit qe udhetojne jashte edhe kthehen kane te detyruar 14 dite karantinim. Femijet mund te kthehen ne shkolle vetem pasi karantinimi i tyre ka mbaruar dhe te jete i vertetuar.

Komunikime te metejshme

Sic e permendem dhe mesiper infomacione te metejshme do te dergohen per cdo klase. Ju lutem komunikoni direkt me mesuesin kujdestar per shqetesimet tuaja. Gjithashtu javen e ardhshme do t'ju dergojme video dhe foto te pergatitjeve qe kemi bere per klasat. Ne qofte se keni pyetje te metejshme ju lutem na kontaktoni ne kete adrese emaili (the.independent@hotmail.com).

Sinqerisht

Drejtoresha

Mynevere Hasanaj